

ETHEM LIKAJ

DISA ÇËSHTJE TË KATEGORISË GRAMATIKORE TË DIATEZËS
NË GJUHËN SHQIPE

Në këtë kumtesë ne do të shtjellojmë jo kategorinë gramatikore të diatezës në tërësi, por vetëm disa çështje, që i dikton vetë materialit i gjuhës shqipe dhe që kanë të bëjnë kryesisht me përkufizimin e diatezës dhe me grupimin e foljeve në diatezë.

Në përkufizimin tradicional të diatezës në përgjithësi janë ndjekur kritere të veçuara, herë kriteri sintaksor, herë kriteri morfologjik etj. Nganjëherë në përkufizimin e saj është ndjekur një kriter, kurse për grupimin e foljeve në diateza është ndjekur një kriter tjetër.

Diateza në gramatikën e K. Cipos është përkufizuar, duke u mbështetur vetëm në kriterin sintaksor. Pasaktësia e këtij përkufizimi qëndron jo vetëm se këtu është marrë parasysh vetëm një kriter, por edhe se kategoria gramatikore e diatezës është ngatërruar me kalimtarinë (tranzitivitetin) dhe jokalimtarinë (intransitivitetin). Kuptimi i kalimtarisë dhe jokalimtarisë këtu është lidhur me forma të caktuara fjalësh: me format veprorë, pësore e vetvetore, kurse në të vërtetë duhet të lidhet me fjalën në tërësi.

Në dispencën e hartuar për studentët e Fakultetit të historisë dhe të filologjisë përkufizimi i diatezës është zgjeruar, duke marrë parasysh edhe kriterin morfologjik. Megjithatë ky përkufizim nuk e justifikon ndarjen e foljeve në diateza: së pari, se është lënë jashtë vështrimit kriteri leksikor dhe së dyti, se kriteri sintaksor është parë ngushtë. Me kriter sintaksor është kuptuar vetëm lidhja midis subjektit dhe objektit të veprimit. Po t'i përmbahemi këtij përkufizimi, atëherë jashtë klasifikimit duhet të mbeten foljet e diatezës mesore, të cilat nuk shprehin kurrfarë marrëdhënjeje të subjektit dhe objektit të veprimit: këtu objekti i veprimit mungon.

Jashtë vështrimit janë lënë edhe foljet jokalimtare si folje, që nuk shprehin raporte midis subjektit dhe objektit të veprimit dhe që nuk janë në opozicion formal e kuptimor me foljet e diatezës veprorë.

Një qëndrim i tillë na duket i padrejtë për këto arsye:

1. Foljet jokalimtare janë në opozicion kuptimor dhe formal me foljet e diatezave të tjera (për këtë do të flasim më poshtë).

2. Edhe foljet e diatezës mesore nuk janë në opozicion nga forma me foljet e diatezës pësore e vetvetore, por, megjithatë, për ato është pranuar kategoria gramatikore e diatezës.

3. Kategoria gramatikore e diatezës është lidhur vetëm me shprehjen e raporteve midis subjektit dhe objektit të veprimit.

Ne kategorinë gramatikore të diatezës e lidhim kryesisht me kryefjalën dhe foljen.

Kryefjala mund të vepronë mbi një objekt ose të pësojë veprimin e vet apo një veprim që drejtohet nga jashtë. Në varësi nga ky ndryshim i gjendjes së kryefjalës duhej të ndryshonte edhe forma e foljes, por s'ndodh kështu, sepse kategoria gramatikore e diatezës s'është thjesht një kategori morfologjike, por edhe leksikore e sintaksore. Kështu, atë funksion që nuk e kryen folja vetëm me mjetet morfologjike, e kryejnë kuptimi leksikor dhe mjetet sintaksore.

Duke u nisur nga vërejtjet e mësipërme, po japim këtë përkufizim për diatezën: kategoria gramatikore e diatezës tregon një gjendje¹ të kryefjalës, që shprehet nga folja në një formë e ndërtim sintaksor të caktuar.

Përdorimi i termit gjendje në përkufizimin e diatezës vetëm e zgjeron konceptin mbi diatezën. Foljet, çfarëdo kuptimi leksikor të kenë, në çfarëdo forme qofshin, në çfarëdo raporti sintaksor të vendosen, karakterizojnë kryefjalën. Zgjerimi i konceptit mbi diatezën e dikton vetë materiali i gjuhës shqipe.

Përkufizimi i diatezës, edhe pse s'e përmban togun «shprehje e raporteve», prapëseprapë nuk e përjashton atë. Kryefjala mund të vendoset në raporte të ndryshme ose jo.

Sipas këtij përkufizimi foljet në gjuhën shqipe mund të grupohen në këto diateza: veprorë, jokallimtare, pësorë, mesorë dhe reciproke.

Në diatezën veprorë folja është atëherë kur në formën veprorë dhe në një ndërtim të caktuar sintaksor shpreh një veprim të kryefjalës që bie mbi një kundrinë të drejtë.

Kundrina e drejtë mund të jetë shprehur ose jo. Kur kundrina nuk është shprehur, folja do të merret në diatezën veprorë, jo sa herë që ajo përdoret me një kuptim të tillë, që e lejon të marrë një kundrinë të drejtë, çfarëdo, por vetëm atëherë kur kundrina nuk është shprehur në rrethana të caktuara; ndryshe ajo është në diatezën jo-veprorë.

Ne mendojmë se edhe foljet jokallimtare përbëjnë një diatezë më vete.

Në trajtimin e kategorisë gramatikore të diatezës deri tani, gjithmonë duke u nisur nga kritere të veçuara, për foljet jokallimtare s'është pranuar kategoria gramatikore e diatezës, meqë ato s'janë në opozicion me foljet e diatezës veprorë.

Në të vërtetë, këto folje, janë edhe në opozicion kuptimor edhe në opozicion formal me foljet e diatezave të tjera.

Opozicioni kuptimor nuk duhet parë vetëm tek një folje: këtu flitet në tërësi për grupe foljesh, flitet për opozicion kuptimor kategorial. Duke i parë kështu, foljet jokallimtare emërtojnë gjendje a veprime që mbeten tek kryefjala, kurse foljet e diatezës veprorë emërtojnë veprime që bien mbi një kundrinë të drejtë. Këtu qëndron opozicioni kuptimor.

Edhe opozicioni nga ana e formës nuk duhet parë vetëm në kufijtë e vetë fjalës (të foljes), sepse, siç e kemi theksuar edhe më parë, kategoria gramatikore e diatezës, s'është një kategori thjesht morfologjike, por edhe sintaksore. Kështu që opozicioni formal duhet kër-

1) Lidhur me përkufizimin e diatezës është e nevojshme të sqarohet ç'duhet kuptuar me termin gjendje. Termi gjendje në përkufizim nuk duhet lidhur vetëm me foljet, që tregojnë gjendje. Ne, duke e lidhur këtë term gjithnjë me kryefjalën, i japim atij një kuptim më të gjerë: kryefjala është në gjendje aktive apo pasive.

kuar këtu në kundërvënjen e dy ndërtimevet dhe jo në kundërvënjen e dy formavet të foljes.

Në diatezën jokalistare folja është atëhere kur në formën veprorë dhe në një ndërtim të caktuar shpreh një veprim a gjendje² të kryefjalës që s'i kalon kufijtë e saj. P.sh.: Po ushtria jonë heroike nuk flinte.. (Enver Hoxha, Vepra II, f. 340).

Formën pësore-mesore e kanë foljet, që sipas traditës janë quajtur të diatezës pësore dhe vetvetore.

Vetëkuptohet se për të bërë një dallim midis tyre, vetëm forma, d.m.th. tipari morfologjik, është i pamjaftueshëm, mjeti morfologjik ndihmon këtu vetëm për t'i dalluar ato nga foljet e diatezës veprorë e jokalistare.

Një grup foljesh në këtë formë e në një ndërtim të caktuar emërtojnë një veprim të jashtëm që bie mbi kryefjalën. Duke pasur parasysh këtë aspekt, në këto ndërtime duhet të jetë shprehur ose të nënkuptohet plotësi i vepruesit, që të shprehet gjendja e saktë e kryefjalës. ndryshe s'mund të kuptohet që kryefjala pëson një veprim të jashtëm. P.sh. ...ato *ruhen* dhe mbrohen me heroizëm *nga kufitarët* tanë trima ... (E. Hoxha, Raport mbi veprimtarinë e KQP. Kong.IV, f. 131). Të kemi vendosje në punën tonë, se lufta *bëhet* me vepra dhe jo me fjalë (E. Hoxha, Vepra I, f. 214).

E njëjta gjendje e kryefjalës shprehet edhe kur në ndërtime të këtij lloji është shprehur apo nënkuptuar plotësi i shkakut. P.sh. Nga *granatat* e partizanëve autobлиндat *dërmohen* dhe ikin. (M. Shehu, Lufta për çlirimin e Tiranës, f. 74). Në këtë formë paraqitet edhe një grup tjetër foljesh. P.sh. Ata *vishen*, *mbathen*, *armatosen* dhe luftojnë kundër fashizmit (N. Prifti, Një pushkë më shumë, f. 31).

Nga shembulli i mësipërm del qartë që edhe subjekti edhe objekti i veprimit treten tek kryefjala, në kuptimin që kryefjala edhe vepron edhe e pëson veprimin e vet në të njëjtën kohë. Këtu kemi të bëjmë me një gjendje tjetër të kryefjalës.

Këto folje në këtë formë e në një ndërtim të caktuar shprehin një veprim të kryefjalës; nga kjo pikëpamje ato bashkohen me foljet e diatezës veprorë, por ky veprim i kryefjalës bie mbi vetë kryefjalën. Këtu ato bashkohen me pësoret.

Vetëm mungesa e përemrit vetvetor *veten* ndryshon në këto ndërtime formën e foljes nga veprorë në pësore-mesore. Duhet të kemi një objekt gramatikor të jashtëm, d.m.th. të ketë një ndarje gramatikore midis kryefjalës si subjekt dhe si objekt veprimi që folja të ruajë trajtën veprorë. Në qoftë se vetëvetori shfaqet qoftë edhe në trajtën e pjesëzës, siç është rasti në të kryerën e thjeshtë, folja ruan *formën* veprorë. Krah. p.sh. Ata *vishen*, *mbathen*, *armatosen* dhe luftojnë kundër fashizmit (N. Prifti, Një pushkë, f. 31). por Ata *u veshën*, *u mbathën* etj.

Këto folje shprehin gjithmonë një veprim të kryefjalës, prandaj ato emërtojnë në radhë të parë veprime reale fizike. Kjo është edhe arsyeja që kryefjala duhet të jetë frymor.

Veprimi i shprehur nga folja drejtohet ose mbi mbarë subjektin ose mbi një pjesë të tij. Tipari karakteristik i këtyre foljevet është

2) Termi *gjendje* këtu përdoret me kuptimin e mirëfilltë.

mundësia që kanë ato për të marrë si kundrinë të drejtë në trajtën veprore atë pjesë të subjektit mbi të cilin ushtrohet veprimi.

Unë krihem: unë kreh flokët.

Unë lahem: unë laj duart, kokën etj.

Tek një grup foljesh në këtë formë veprimi i kryer nga kryefjala është një veprim i brendshëm, që ka të bëjë me mbarë kryefjalën P.sh. Pastaj, në rrëmujë e sipër, gjetën rast dhe *u vërsulën* përpjetë malit... (A. Abdihoxa, Endrra dhe dritë, f. 27).

Foljet e këtij grupi nuk mund të kenë përgjegjeset e tyre në trajtën veprore me përemrin vetëvetor. Kjo ndodh nga që veprimi lidhet me mbarë kryefjalën dhe s'është nevoja të përdoret vetëvetori. Por kur këto sajohen nga foljet përgjegjëse të diatezës veprore, atëhere mund të marrin përemrin vetëvetor si kundrinë të drejtë.

Këto grupe foljesh edhe pse kanë disa veçori, që i dallojnë nga njëra-tjetra, mund të përfshihen në një diatezë të vetme për këto arsye:

1. Veprimi i shprehur nga folja lidhet gjithmonë me kryefjalën dhe s'i kalon kufijtë e saj;

2. Mungojnë mjetet morfologjike për të dalluar grupin e parë nga i dyti (s'ka ndarje gramatikore — kryefjalë — kundrinë e shprehur me përemrin vetëvetor).

Këto dy grupe foljesh mund të përfshihen në diatezën mesore.

Folja, pra, është në diatezën mesore, kur në formën pësore-mesore dhe në një ndërtim të caktuar sintaksor shpreh një veprim a gjendje (në kuptimin e mirëfilltë) të kryefjalës, që s'i kalon kufijtë e saj.

*

Nganjëherë kryefjala si subjekt kryen një veprim të njëjtë me një tjetër subjekt. P.sh. «baballarët e kombit» *kacafyten!* (Ll. Siliqi Vjersha dhe poema, f. 17); këtë gjendje të kryefjalës folja e shpreh me formën pësore-mesore. Foljet në këto ndërtime shprehin një veprim të kryefjalës, që bie mbi një objekt të jashtëm; nga kjo pikëpamje ato puqen plotësisht me foljet e diatezës veprore. Por me veprorët ato kanë një dallim esencial — ato pësojnë në të njëjtën kohë një veprim të njëlojtë, por nga jashtë. Këtu ato takohen me pësorët, nga të cilat veçohen, ngaqë kryefjala tek këto të fundit është krejt pasive (ajo vetëm pëson një veprim të jashtëm).

Siç shihet, lidhjet midis këtij grupi foljesh dhe foljevet të diatezës pësore dhe veprore gërshetohen. Por për arsye të dallimevet që përmendëm më sipër, ato s'mund të përfshihen as tek veprorët as tek pësorët. Kurse me mesorët ato s'i bashkon asgjë. Në qoftë se këto folje do t'i gruponim tek mesorët vetëm se ato shprehin gjendjen aktive e pasive të kryefjalës në të njëjtën kohë, atëhere duhet shtuar se:

1. Veprimi i kryefjalës i kalon kufijtë e saj,

2. Kryefjala s'pëson veprimin e vet, por një veprim të jashtëm.

Prandaj ne mendojmë se këto folje duhen të përfshihen në një diatezë të veçantë.

Foljet janë në diatezën reciproke, kur në formën pësore-mesore dhe në një ndërtim sintaksor të caktuar shprehin veprimin e kryefjalës, e cila pëson veprimin e njëjtë nga objekti i saj i veprimit.

Siç shihet, në kumtesë dalin jashtë vështrimit kategorial të diatezës foljet pavetore.

Ne, pa dhënë një gjykim të prerë, mendojmë se këto folje nuk kanë diatezë. Në ndërtimet me folje pavetore kryefjala mungon. Kështu që folja s'ka si të shprehë gjendjen e saj. Në këto ndërtime vëmendja kryesore nuk përqendrohet në shprehjen e kësaj apo asaj gjendjeje të kryefjalës, por në procesin vetë. Megjithatë ky grup foljesh kërkon një studim të veçantë.

Në këtë kumtesë ne vetëm sa prekëm disa çeshtje themelore të kategorisë gramatikore të diatezës në shqipen, pa i shtjelluar ato gjatë. Një studim më i thellë nga ana teorike e kësaj kategorie dhe veçanërisht operimi me një material më të pasur të shqipes, do të jepte rezultate më pozitive.

